

**Prot. 2211/230 K (e-k)**

**Datë, 22/11/2022, Tiranë**

**Lënda:** *Partia Balli Kombëtar Demokrat*

*Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin*

*financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!*

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin **PBKD**, KRIIK ka konstatuar se:*

*- partia ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por në raportin e vetëdeklarimit ka deklaruar 0 shpenzime në këtë zë;*

*- mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

### **Lidhur me Shpenzimet e partisë në Facebook dhe Instagram**

Partia Balli Kombëtar Demokrat për faqen në Facebook të së cilës është paguar shuma 41.964 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

### **Lidhur me bilancin e aseteve dhe detyrimeve**

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se PBKD nuk ka dorëzuar bilancin e aseteve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

**Me konsideratë,**

***Për Koalicionin Për Reforma, Integrim***

***dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)***

**Premto Gogo**

Address:

Rr. "Ymer Kurti",  
Nd.4, H.2, Ap.3,  
Nj.Adm.5,  
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396  
Tirana, 1001,  
Albania